

LIGJ
Nr.9229, datë 29.4.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8950, DATË 10.10.2002 "PËR
GJENDJEN CIVILE"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin 8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Pika 5 e nenit 34 ndryshohet si më poshtë:

"5. Deklarimi i lindjes së fëmijës bëhet brenda 45 ditëve. Pas mbarimit të këtij afati, lindja konfirmohet me vendim gjykate."

Neni 2

Shkronja "b" e pikës 3 të nenit 35 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 37 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Ndryshimi i emrit e i mbiemrit bëhen në librin e procesverbaleve, pas miratimit të kërkesës së shtetasit nga punonjësi i zyrës së gjendjes civile, ku ka regjistrin themeltar. Në procesverbal pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, shkaku i ndryshimit, si dhe emri e mbiemri të ndryshuar. Procesverbali nënshkruhet nga kërkuesi, nga të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin, kur e pranojnë ndryshimin, nga punonjësi i gjendjes civile dhe drejtuesi i zyrës së gjendjes civile, nëse ka të tillë. Emri e mbiemri të ndryshuar, si dhe numri dhe data e procesverbalit pasqyrohen në regjistrin themeltar të gjendjes civile."

2. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

"10. Ndryshimet dhe korrigjimet e bëra në zyrën ku ndodhet regjistri themeltar i gjendjes civile u dërgohen, brenda 10 ditëve, Zyrës së Gjendjes Gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe qendrave të rekrutim-mobilizimit të qarqeve përkatëse."

Neni 4

1. Në pikën 3 të nenit 50, fjalët "brenda tri ditësh" bëhen "brenda dhjetë ditësh".

2. Pika 6 e nenit 50 shfuqizohet.

Neni 5

1. Pikat 1 dhe 2 të nenit 69 ndryshohen si më poshtë:

"1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e përmendura më poshtë, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

a) shkelja ose moszbatimi i dispozitave të parashikuara në nenet 12 pika 5 dhe 50 pika 3 dënohet me gjobë në masën 1 000 lekë;

b) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në pikën 5 të nenit 34 dënohet me gjobë në masën 2 000 lekë;

c) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në pikën 2 të nenit 63 dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë.

2. Gjobat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" vendosen nga punonjësi i gjendjes civile. Veprimet pezullohen deri në pagimin e gjobës. Kundër masës administrative mund të bëhet ankim, brenda 10 ditëve, te prefekti i qarkut, i cili brenda 15 ditëve duhet të shprehet për këtë masë. Kundër vendimit të prefektit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

Gjoha e parashikuar në shkronjën "c" vendoset nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile. Kundër masës administrative mund të bëhet ankim, brenda 10 ditëve, te Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, i cili brenda 15 ditëve duhet të shprehet për këtë masë. Kundër vendimit të ministrit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.".

Neni 6

Neni 72 shfuqizohet.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4236, datë 26.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**